



Ne prag te miqesores me Uzbekistanin trajneri i kombetares shqiptare Josip Kuzhe po vijon pergatitjet. Te gjithë lojtaret e therritur prej tij nga pasditja e te djeles jane bashkuar ne “Hotel Tirana Internacional”, aty ku kuqezinjte do te qendrojne te grumbulluar per kete takim. Perfaqesuesja shqiptare po pergatitet intesivisht per ndeshjen e fundit miqesore me Uzbekistanin, takim qe do ti paraprije fushates se elimatoreve te Euro 2012-se.

Ne pasditen e te henes kombetarja shqiptare e ka pasur te veshtire te gjeje nje fushe per te zhvilluar stervitjen e rradhes. Ne stadiumin Selman Stermasi po stervitej ekipi i Uzbekistanit, ndersa ne Skender Halili Tirana po zhvillonte stervitjen e rradhes. Bardheblute pasi kane mesuar veshtiresine e kombetares per te gjetur terren per stervitje i kane hapur rruge ketyre te fundit duke lene stervitjen e tyre pergjysem.

Kuzhe ka projektuar formacionin e mundshem per miqesoren e te merkures. E vecante kete rradhe do te jete aktivizimi i Muzakes nga minuta e pare. Kuzhe ka projektuar mesfushorin e Dinamos si nje nga prurjet e reja per elimatoret e rradhes.

Pozitive gjithashtu eshte dhe rikthimi i Beqajt ne porte, pas nje periudhe te gjate qe ai ka munguar si pasoje demtimesh. Do te rikthehet gjithashtu edhe Kristi Vangjeli ne linjen e majte te mbrojtjes.

Mungesa e kapitenit Skela ne kete miqesore, ka bere qe trajneri Josip Kuzhe t’ja jape shiritin e kapitenit Lorik Canes. Kosovari ka mbajtur rolin e zv/kapitenit ne kohen qe ishte Skela ne fushe dhe mungesa e tij tashme e ka “rritur ne detyre”.

Gjate diteve pergatitore para miqesores me Uzbekistanin, per Kuzhen kane qene te gjithë

Kombetarja/ Uzbekistani, prova gjenerale para eliminatoreve

nga AlbaniaSoccer

E martë, 10 Gusht 2010 22:35

lojtaret te gatshem dhe askush nuk eshte i demtuar ne kete periudhe.

Formacioni mundshem i Kombetares

4-4-2

Beqaj

Dallku Cana Curri Vangjeli

Muzaka Duro Bulku Agolli

Salihi Bogdani